



22.03.2020

## Letër për prindër nr. 3

# Rregullorja e re për përkujdesjen e fëmijëve nga personat, që janë duke punuar në infrastrukturë kritike (personat kyç)

**APEL I RËNDËSISHËM**  
**në të gjithë prindërit,**  
**të cilët për shkak të rregullores së re**  
**kanë të drejt për përkujdesje të fëmijëve**

Për të siguruar mbarëvajtjen e infrastrukturës kritike për të mirën e përgjithshme Qeveria e Landit ka vendosur, që çdo person, që vepron në infrastrukturë kritike, dhe mund ta jap një vërtetim të punëdhënësit që është i pazëvendësueshëm, pavarësisht nga gjendja familjare ka të drejtë për përkujdesjen e fëmijëve të tij në një institucion të kopshteve të fëmijëve, nëse përkujdesja e fëmijëve nuk mund të organizohet me përgjegjësi të plotë dikund tjetër – në përputhje me rekomandimet e RKI-së.

Kjo rregullore vlen nga 23.03.2020 dhe vlen si për përkujdesjen në institucionet e kopshteve të fëmijëve poashtu edhe në institucionet e fëmijëve, që kanë nevojë ditore mjekësore.

### **Ne apelojmë poashtu tek prindërit:**

Nga arsyet e mbrojtjes nga infektionet **do të duhej që të shfrytëzohet kjo rregullore në masën e minimumit të saj.** Ju lutem, që t'i sillni fëmijët në kopsht vetëm nëse keni **me të vertetë** nevojë për përkujdesje dhe nuk mund ta bëni organizimin vetë ose me vetëpërgjegjësi - sipas rekomandimeve të RKI-së.

**Ndihmoni në ngadalësimin e përhapjes së koronavirusit**, në mënyë që numrin e përkujdesjeve në kopsht mos ta rrisni më shumë se që është e nevojshme. Ta keni parasysh, që me çdo kontakt plotësues jashtë familjes **rritet rreziku i infektimit** për fëmijun tuaj dhe familjen tuaj. Ju lutem mendoni edhe në shëndetin dhe mirëqenien e kujdestareve dhe kujdestarëve në kopshtet e fëmijëve.

E gjithë popullata është e thirrur, që të mënjanoj kontaktet sociale sa është e mundur.  
**Ju lutem merrni pjesë edhe ju në këtë.**

**Ministria për Fëmijë, Familje, Refugjat dhe Integrim i Landit Nordrhein-Westfalen**